



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I STUDIMEVE TË KRIMEVE DHE PASOJAVE TË KOMUNIZMIT

Rruja: George W. Bush

Nr. 605 prot

3

Datë 1.10.2018

Lënda: Vendim i Bordit dhe Këshillit Shkencor të ISKK për natyrën e botimeve

Bordi Drejtues dhe Këshilli Shkencor i ISKK, pasi morën në shqyrtim kolanën e botimeve për vitin 2018, që paraqiti Drejtori Ekzekutiv i Institutit, z. Agron Tufa, vendosi në mbledhjen e datës 1 tetor 2018, mosbotimin e çarëdo dorëshkrimi të tipit *fiction*, edhe pse narrativa e tyre trajton temën e përndjekjes politike e klasore nga rregjimi totalitar komunist. Pa mohuar rëndësinë dhe vlerën artistike të këtyre librave letrarë (romane, novela, tregime, poezi dhe përkthime), Bordi dhe Këshilli shkencor i ISKK, mendon se Instituti ka prioritet të ngutshëm dëshmitë e drejtëpërdrejta dokumentare, vizuale apo gojore, në përputhje me atë çka përcaktohet nga Ligji nr. 10242, datë 25.02.2010 për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, e pikërisht në "Detyrat" e tij, të shprehura qartë në nenin 5, në pikat "g", "gj", "h", ku thuhet se Instituti:

g) sistemon dhe boton kujtimet e të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;

gj) përpunon, në formë elektronike, të gjithë dokumentacionin për krimet e regjimit komunist në Shqipëri;

h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon eksposita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri;

Rrjedhimisht, për sa më sipër, pa mohuar rëndësinë e dëshmisë letrare të dorëshkrimeve të paraqitura, Bordi dhe Këshilli Shkencor i ISKK, e konsideron jo të ngutshëm botimin e librave fiction, duke u përqendruar tek dëshmitë, memuaristika, albumet, studimet me materiale arkivore e burime dokumentare dëshmuese.

Kryetari i Bordit Drejtues të ISKK

Kryetari i Këshillit Shkencor të ISKK